



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:091248

Datë: 16.06.2021

Numri i dokumentit: 01893166

PKR.nr.102/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me zyrtaren ligjore Adelina Brestovci, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.I., nga ., Komuna e Vitisë, të cilin sipas autorizimit e mbron avokat Burhan Qosa nga Ferizaji, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. 82/2021, të datës: 24.05.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datë: 15.06.2021, bie dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari

A. I., nga babai H. dhe nëna D. , e lindur L., i lindur me datë ..., në Komuna e Gjilanit, tani me vendbanim në, Komuna e Vitisë, i martuar, baba i një fëmiju, pensionist, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:1002793888.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se në kohë të papërcaktuar e deri me datë 15.04.2021, ka siguruar dhe mbajtë në pronësi në mënyrë të paautorizuar armët e zjarrta dhe atë: një pushkë automatike ... kondak metali, me mbishkrim ..., me numër serik ..., kal.7.62 mm, një pushkë automatike AK... me

kondak druri, me numër serik ... kal.7.62 mm, dy karikatorë kal.7.62 mm dhe 34 fishekë kal.7.62 mm, të cilat me datën e sipërshtuar gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në fshatin .. Komuna e Vitisë, janë gjetur dhe i janë konfiskuar përkohësisht nga ana e policisë së Kosovës.

- **Me çka ka kryer veprën penale penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par.1, të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7,17, 21, 38,40, 48, 69,107, dhe 366 par.3, të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës .

E G J Y K O N

Të akuzuarin A. I., e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi i pushkës automatike..., me kondak metali, me mbishkrim ..., me numër serik ..., kal.7.62 mm, një pushkë automatike ...me kondat druri, me numër serik ..., kal.7.62 mm, dy karikatorë kal.7.62 mm dhe 34 fishekë kal.7.62 mm.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) euro, 50 (pesëdhjetë) euro për viktimat e krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.82/2021, të datës: 24.05.2021, kundër të akuzuarit A. I., nga Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1. të KPRK-ës dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Shaban Spahiu, fillimisht mbeti pranë aktakuzës, deri sa pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit në deklarinimin mbi dënimin i propozojë gjykatës që me rastin e shqiptimit të

dënimit, si rrethanë lehtësuese, ta marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës, pendimin për këtë, gjendjen e varfër ekonomike, kurse si rrethanë rënduese rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale, përkatësisht faktin se i janë zënë dy armë, përkatësisht pushka automatike me 34 fishekë.

Mbrojtësi i të pandehurit A. I., av.Burhan Qosa i propozoi gjykatës që si rrethana lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit ti marrë për bazë të njejtat rrethana lehtësuese që i ceku edhe prokuroti i shtetit, ndërsa me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese të marrë parasysh deklarimin e të pandehurit në polici, ku ka sqaruar arsyet për të cilat armët kanë mbetur tek ai. I njejt i propozon gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptojë një dënim me kusht konform nenit 49 të KPRK-së, duke e marrë parasysh edhe gjendjen e varfër ekonomike dhe bindjen se me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi mbi të cilin Kodi Penal ka vlerësuar kur gjykata shqipton dënime të tilla.

I akuzuari A. I., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe se këtë pranim të fajësisë e bëri vullnetarisht pa u ndikuar nga askush dhe pranimi i fajësisë është bërë pa kurrfarë presioni dhe i njoftuar nga gjykata për benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë. I akuzuari në deklarimin e tij mbi dënimin deklaroi se i vie keq për veprën kryer penale, se është penduar, premtoi që në të ardhmen nuk do të kryer asnjë vepër tjetër penale, më parë nuk kam qenë i gjykuar për vepër penale. I propozoj gjykatës që me rastin e caktimit të dënimit, të më shqiptoj ndonjë dënim më të butë, në mënyrë që të jetë më i përballueshëm.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: raportimi oficerit me nr. .. i dt. 15.04.2021, fotodokumentacioni, procesverbali mbi konfiskimin e armëve të zjarra si dhe pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ashtu që në këtë mënyrë u vërtetua se i akuzuari në kohë të papërcaktuar e deri me datë 15.04.2021, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar armët e zjarra dhe atë: një pushkë automatike ... me kondak metal, me mbishkrim 1998, ... me numër serik ..., kal.7.62 mm, një pushkë automatike ... me kondak druri, me numër serik ..., kal.7.62 mm, dy karikatorë kal... mm dhe 34 fishekë kal7.62 mm, të cilat me datën e sipërshënuar gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në fshatin, Komuna e Vitisë, janë gjetur dhe i janë konfiskuar përkohësisht nga ana e policisë së Kosovës dhe në këtë mënyrë ka kryer veprën penale penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par.1, të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 69 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se më parë nuk ka kryer ndonjë vepër tjetër penale si dhe moshën e tij të shtyrë.

Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore duke qenë se posedimi armës pa leje paraqet rrezik për popullatën dhe faktin me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës.

Vendimi mbi dënimin plotësues konfiskimi i armëve të zjarrit: Pushkë automatike ... me kondak metal, me mbishkrim 1998, ..., me numër serik ..., kal.7.62 mm, një pushkë automatike ... me kondak druri, me numër serik 092202-90, kal.7.62 mm, dy karikatorë kal... mm dhe 34 fishekë kal7.62 mm, është bazuar në nenin 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 102/2021 Me datë.16.06.2021

Zyrtare ligjore
Adelina Brestovci

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.